

Bootable USB fflash me Windows 7

Së pari nevojitet që kompjuteri juaj të mund të “startoj” (**booted**) nga USB fflashi (ngritja e sistemit).

Me gjithë këto performancat e kompjuterit duhet të jenë:

1. USB fflash me kapacitet prej 4 GB (fshij të gjitha të dhënat nga USB),
2. Një disk me Windows 7 për instalim,
3. Sistem operativ të instaluar në kompjuter: Windows XP, Vista apo 7.
4. Mundësinë që të bëjmë “boot” nga memoria USB (shikoni në BIOS-in e PC-së suaj).

Kjo metodë bazohet në Command Prompt gjatë krijimit të “*booted USB fflash*”.

Hapi 1

Vendosni USB-në tuaj në kompjuter.

Në këtë kompjuter në sistemin operativ Windows klikoni në START dhe në fushën për kërkim (Search Box) shënoni urdhëresën **diskpart**.

```
Microsoft DiskPart version 6.1.7601
Copyright (C) 1999-2008 Microsoft Corporation.
On computer: ANKURMITTAL

DISKPART>
```

Hapi 2

Në këtë hap në dritaren e hapur të Command Prompt-it shënoni urdhëresën **list disk** për të parë gjendjen e HDD-së suaj. Numri **1** ju asocion në USB fflash-in tuaj.

```
DISKPART> list disk

Disk ###  Status              Size               Free               Dyn  Gpt
-----  -
Disk 0    Online              298 GB             2048 KB            *
Disk 1    Online              3819 MB             0 B
```

Hapi 3

Në këtë hap shënoni urdhëresën **select disk 1**

```
DISKPART> select disk 1  
Disk 1 is now the selected disk.  
DISKPART>
```

Hapi 4

Në këtë hap shënoni urdhëresën **clean** për ta pastruar USB-në tuaj.

```
DISKPART> clean  
DiskPart succeeded in cleaning the disk.  
DISKPART>
```

Hapi 5

Tash shënoni urdhëresën **create partition primary**

```
DISKPART> create partition primary  
DiskPart succeeded in creating the specified partition.  
DISKPART>
```

Hapi 6

Në këtë hap shënoni urdhëresën **active**

```
DISKPART> active  
DiskPart marked the current partition as active.  
DISKPART>
```

Hapi 7

Shënoni urdhëresën **format fs=NTFS quick** për të formatuar USB-në dhe prisni deri sa të formatohet.

```
DISKPART> format fs=NTFS quick  
  
100 percent completed  
  
DiskPart successfully formatted the volume.  
  
DISKPART>
```

Hapi 8

në këtë hap shënoni urdhëresën **assign**.

```
DISKPART> assign  
  
DiskPart successfully assigned the drive letter or mount point.  
  
DISKPART>
```

Hapi 9

Datotekat (fajllat) e Windows 7 nga DVD-ja kopjoni në USB.

Me këtë përfundoi procedura. Tani e keni te gatshëm USB flashin për të instaluar Windows 7